

Nr. 132/2 Prot
Nr. 0009-21 Dosje

Tiranë më, 2209 2022

**URDHËR
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"**

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit

Adresa: Tiranë

Per dijeni: Debitorit : Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk Nipt L82418029E

Adresa: territori i Uzines ferrokromit, Paper, Elbasan

Kreditor : Shoqeria "International Security Albania" shpk Nipt L02004016V

Adresa: Tirane

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Privat "BESA" sh.p.k, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me numër 0009-21 regi dhe me palë:

Kreditor : Shoqeria "International Security Albania" shpk Nipt L02004016V

Debitorit : Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk Nipt L82418029E

Objekti : Likujdim Fature

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv "Fatura Tatimore Nr.3, datë 31.01.2020; Fatura Tatimore Nr.20, datë 29.02.2020", është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit "Vendimi Nr.464 Akti, datë 12/03/2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan", me palë kreditore Shoqeria "International Security Albania" shpk dhe palë debitore Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk.

Me vendim të përmbarruesit gjyqësor privat, mbështetur dhe në nenin 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet të kryhet verifikimi dhe vendosja masës së sekuestros në QKB, mbi aktivin që zotëron pala debitore.

Për këtë arsye në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe Ligjit Nr.26/2019, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në aksionet, kuotat e debitorit:
- Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk me Nipt L82418029E, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimin e këtyre aksioneve/kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të ekzekutimit brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Zyra e Përmbarrimit Privat "BESA" sh.p.k
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Klodiana TABAJ